EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

# GJUHË SHQIPE

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

_____
EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

| NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

_____
NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola: http://mojasrednjaskola.gov.rs** duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

**Shifra e veçantë e testit**: 228202330418

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

UDHËZIME PËR PUNË

• Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta.**
• Shkruaj mirë, në mënyrë qe shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
• Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
• Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laprs të thjeshtë grafik dhe gomë).
• Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps "shkruaj – fshij" nuk do të pranohet.
• Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
• Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
• Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
• Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet ( ), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

**SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR**

| Tek detyra me një përgjigje të saktë |
|---|
| Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.<br>○ Novi Sadi<br>● Beogradi<br>○ Nishi<br>○ Krushevci |

| Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta |
|---|
| Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.<br>● 2 + 3<br>○ 1 + 2<br>● 4 + 1<br>○ 2 + 4<br>○ 3 + 5 |

• Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

# TESTI
# GJUHË SHQIPE

**1.** Dallo cili nga këto tekste është tekst gazetaresk?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

○ Fabula ○ Tregimi ○ Reportazhi ○ Novela

**2.** Cili grup i shkronjave të përbëra është i renditur sipas alfabetit.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

○ dh, sh, gj, th, rr, ○ dh, ll, gj, nj, sh, ○ dh, gj, ll, nj, rr, ○ dh, nj, gj, ll, sh,

**3.** Në fjalinë e dhënë ngjyros rrethin nën fjalën që duhet të shkruhet me shkronjë të madhe.

| lumi | buna | bashkohet | me | lumin | drin | rreth | 2 km | në | jugperëndim | të | shkodrës. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ○ | ○ | ○ | | ○ | ○ | | | | ○ | | ○ |

**4.** Fjalët e shënuara më poshtë ndaj në rrokje.

dëgjoi - _____

fjalë - _____

zanore - _____

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**5.** Trego çfarë lloji i fjalisë është fjalia e dhënë:

Mos u përkul!

Ngjyros rethin para përgjigjes së saktë.

- ◯ pyetëse
- ◯ dëftore
- ◯ urdhërore

**6.** Lexo me kujdes tekstin e dhënë dhe trego në cilin dialekt është shkruar.

Për vete e ke

E zen njanin nata në një katun e shkon me lypë konak te njani. Kur shkon aty, i zoti i shpisë i ban muhabet e munohet me ba nderë me të ngrëna, me zjerm e shroje. Por i zoti i shpisë ish kanë pak i lehtë prej menje e çohet e pyet musafirin;

- A të bana boll muhabet?
- Në më paç ba muhabe, për veti e ke - ia kthei plaku.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ◯ gegërishte
- ◯ toskërishte

**7.** Lexo tekstin dhe trego si quhet ky lloj teksti?

MASI S'PO MUN E RUEN TI AT FJALË, KAH TA RUEJ UNE?

I kish pasë thanë njani ni shoqi t'vet:
- Po t'kallxoj dishka n'besë, po ti kërkuj mos i kallxo!
Ai tjetri i tha:
- Besa do t'i kallxoj t'tanve. Masi s'po mun e ruen ti at fjalë, kah ta ruej une.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ◯ Anekdotë
- ◯ Përrallë
- ◯ Fabul



Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**8.** Nga shembujt e dhënë, cila nga këto vepra shkruhet në vargje?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

○ tregimi ○ novela ○ poezia ○ drama ○ romani

**9.** Lexo vargjet e dhëna,trego llojin e rimës.

Çdo gjë ikën , po vallë ç'mbetet.
Lumi i jetës rrjedh përsëri,
Veç një gjë nuk mund të tretet,
Një ylber me dashuri.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

○ Rimë e kryqëzuar (ABAB)

○ Rimë e përputhur (AABB)

**10.** Shkruaj sipas normave drejtshkrimore fjalinë e dhënë:

Deti ishte madhshtor, qilli i kthjellt si loti.

_____

**11.** Ne fjalët (rrokjet): dita, jeta, shkolla, dele, mollë, anije, lule, fushë

Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego se ku bie theksi:

○ theks fundor

○ theks parafundor

○ theks tejfundor

**12.** Cilët nga përemrat e mëposhtem janë përemra pronorë?
Ngjyros rrethin para përgjigjeve të sakta:

| ime | yt | ne | ju | tuaj | juaj | ky | ajo |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**13.** Lexo fjalitë e dhëna dhe trego cila nga këto është fjali e përbërë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ○ Ai nuk e kishte pranë familjen, prandaj ndihej i vetmuar.
- ○ Kongresi i Manastirit zgjidhi çështjen e alfabetit, sepse deri në atë kohë shqipja shkruhej me alfabete të tjera.

**14.** Përcakto kohën, vetën dhe numrin e foljes së nënvizuar

Mbrëmë pashë një ëndërr dhe u trishtova në gjumë.

Koha _____;

Veta _____;

Numri _____.

**15.** Jeronim de Rada

Kënga për vdekjen e Skënderbeut

Cila erë do të rrëmbejë vallë këtë trup? O, sa orë hareje shpresoi ai dhe s'pati kurrë! Të rrethuar nga rrufe e dallgë ne s'dimë ku iku toka: mbetëm ne në këto vise. Pse, moj re, ti çahesh dhe hap një qiell të bardhë mbi viset e vendlindjes?

Edhe veriu fryn më fort dhe duke na harruar shkon mbi det. Ndofta nuk e di se për fatin tonë të zi ne jemi brengosur. Ja, lindi agimi i vendit tim. Po shoh prapë fushat e zbehta dhe kodra gjethezeza: ja shtëpitë e nënës sime, ja gratë e rritura me mua, që të ngritura pa gdhirë, dalin në dritaret e shtëpive të vështrojnë detin...

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Pjesa e dhënë është:

- ○ tregim
- ○ prozë poetike
- ○ poezi

**16.** Epopeja dhe këngët mitologjike bëjnë pjesë në:

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ○ poezinë lirike
- ○ poezinë epike



Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**17.** Nëse pohimi është i saktë ngjyros rrethin  në kolonën PO, e nëse pohimi është i pasaktë, ngjyros rrethin në kolonën JO.

| Pohimet | PO | JO |
|---|---|---|
| Legjenda ose gojëdhëna është tekst rrëfyes nga goja e popullit i cili u kushtohen personave ose dukurive që ndodhin apo kanë ndodhur dhe që këta persona apo dukuri kanë lënë gjurmë në jetën e një shoqërie njerëzore. | ○ | ○ |
| Legjendës për dallim nga llojet e tregimeve tjera i dihet saktë koha dhe vendi e zhvillimit të ngjarjes, ose njëri nga këto elemente. | ○ | ○ |
| Gjergj Elez Alia është legjendë e rrëfyer nga goja e popullit. | ○ | ○ |

**18.** Si quhet ndryshimi i tingujve **-k** në –**q**;  **g-** në –**gj**, **r** në –**j**  si në shembujt e mëposhtëm:

plak – pleq; zog – zogj, lepur – lepuj

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

○ rotacizëm ○ apofoni ○ palatalizim

**19.** Më poshtë janë dhënë disa emra.
Ngjyros rrathët në kolonën duhur duke lidhur emrin e dhënë me rasën në të cilën është.

| Rasat | emërore | gjinore | dhanore | kallëzore | rrjedhore |
|---|---|---|---|---|---|
| Rigën | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |
| prej shokut | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |
| djalit | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |
| e Naimit | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |
| lapsi | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ |

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**20.** Në një roman nga planprogrami juaj shkollor përshkruhet fati i mjerë i femrës shqiptare  për fatin e së cilës vendosin të tjerët dhe gjakmarrja kanunore, lexo vargjet më poshtë:

*...Sa shumë e ndryshuan Hajrinë ato tetëmbëdhjetë vjet të martesës së dytë, habitej edhe ajo vetë. Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete marimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aqë të zezë e të gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurr ndonjëherë më parë.*

Fragmenti është nxjerrë nga romani _____

Këtë roman e shkroi _____

Personazhi kryesor i këtij romani është _____



Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

# FAQE E ZBRAZËT

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

# FAQE E ZBRAZËT



Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

# FAQE E ZBRAZËT

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду

**ИНТЕРНО**

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

# GJUHË SHQIPE

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

_____
EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

| NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

_____
NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати
без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.
© 2023 ТестМастер, Факултет организационих наука, Универзитет у Београду